



Pranimi / Dorezuar Priljeva / Prilato Received / Delivered	17.05.2022	2	viti god Year
Organ / Shërbimi Organ / Service	Nr. Prot. Pr. No.	Shtypja e Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKD/MBIKUK	2852/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.252/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Arditë Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë me Arditë Perçuku-Shyti -Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.252/2022 të datës 21.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.252/2022 e datës 21.03.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.5/2/08/2022 i datës 04.03.2022 i Bordit Përzgjedhës për Trajnime Bilaterale në Ministrinë e Mbrojtjes, lidhur me përzgjedhjen e kandidatit fitues.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes sipas ndryshim plotësimit të akt emërimit me numër Nr.Prot.1935 të datës 10.06.2019 në pozitën "Shef i njësisë së Protokollit.

Me datën 25.02.2022, Ministri i Ministrisë së Mbrojtjes ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Prot.383, me të cilin ka emëruar bordin për trajnimet bilaterale lidhur me përzgjedhjen e pjesëtarëve të FSK/personelit civil të MM/FSK-përzgjedhjen e kandidatëve për trajnime jashtë vendit. Në trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security" e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, ka aplikuar edhe ankuesi si i propozuar nga me datën 01.02.2022.

Me datën 04.03.2022, Bordi për Trajnime Bilaterale ka mbajtur takimin dhe sipas procesverbalit të këtij takimi janë përzgjedhur edhe emrat e aplikuesve lidhur me trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security" e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, sipas të cilit ankuesi nuk është përzgjedhur si njëri ndër përfituesit e këtij trajnimi.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.5/2/08.2022 të datës 04.03.2022 të Bordit për Trajnime Bilaterale të Ministrisë së Mbrojtjes, me datën 21.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1458/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky vendim përmban shkelje procedurale, se bordi nuk ka qenë transparent me aplikantët në vendimmarrje, i njëjti pretendon po ashtu se ky bord gjatë procedurave të selektimit ka bërë shkelje lidhur me mohimin për testimin paraprak si dhe po ashtu se ky bord nuk ka marrë për bazë kriteret e përcaktuara për selektimin e kandidatit fitues, i njëjti kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën dhe t'a anuloj vendimin Nr.5/2/08/2022 të datës 04.03.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 25.03.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1588/2022 për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa me datën 04.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29/04/2022 ka nxjerrë vendimin VK.nr.32/2022, sipas të cilit ankesës i është vazhduar afati i vendimmarrjes edhe për 10 ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1458/2022 të datës 21.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.Prot.283 të datës 25.02.2022 lidhur me emërimin e Bordit për Trajnime Bilaterale; Shtojcën 2 lidhur me të dhënat dhe kriteret e përzgjedhjes; Vendimin me numër Nr.5/2/08/2022 të datës 04.03.2022 lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve; Ftesën e datës 17.01.2022 lidhur me trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security" e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022; Opinionin ligjor të datës 18.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2022 nga Ministria e Mbrojtjes me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimin e ankuesit të datës 15.07.2011; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit me numër Nr.prot.1935 të datës 10.06.2019 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër Nr.Prot.383 të datës 25.02.2022 për formimin e Bordit për Trajnime Bilaterale; E-mailat zyrtar të datës 28.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 01.02.2022; E-mailin zyrtar të datës 31.01.2022; E-mailat zyrtar të datës 28.01.2022; E-mailin zyrtar të datës 01.02.2022; E-mailat zyrtar të datës 28.01.2022; Propozimin për trajnim me numër Nr.Prot.137 të datës 31.01.2022; Propozimin për trajnim me numër Nr.Prot.133 të datës 28.01.2022; Aktin përcjellës me numër Nr.Prot.11/59 të datës 04.02.2022; Shkresën lidhur me propozimet për trajnimin Britani e Madhe, Turqi online; E-mailin zyrtar të datës 25.02.2022; Shkresën lidhur me takimin e BTB-së të datës 01.03.2022; Shkresën lidhur me propozimet për trajnimin Britani e Madhe, Turqi online; Procesverbalin e datës 01.03.2022 të takimit të BTB-së; E-mailat zyrtar të datës 01.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 02.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 03.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 02.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 03.03.2022; Takimin e BTB-së të datës 04.03.2022;

Procesverbalin e datës 04.03.2022 të takimit të BTB-së; E-maili zyrtar të datës 04.03.2022; Vendimin më numër Nr.5/2/08/2022 të datës 04.03.2022 lidhur me listën e kandidatëve të përzgjedhur për arsimim dhe stërvitje jashtë vendit; Ankesën e ankuesit të datës 08.03.2022 përmes e-mailit zyrtar; Vendimin me numër VK.nr.32/2022 të datës 29.04.2022 për vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 05.05.2022 lidhur me provat shtesë nga Ministria e Mbrojtjes për ankesën e ankuesit; Akt emërimit të datës 13.03.2020 për zyrtarin Urdhër emërimin me numër 1480 të datës 25.03.2022 për nëpunësin së bashku me pjesët mbi përshkrimin e detyrave të punës; Kontratën e punës të datës 21.01.2012 të nëpunësit Kontratën e punës të datës 21.01.2012 të nëpunësit së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Urdhër emërimin me numër 1572-06 të datës 03.07.2020 për nëpunësin së bashku me pjesën e parë mbi përshkrimin e vendit të punës .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtuara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar Vendimin me numër Nr.prot.383 të datës 24.02.2022 lidhur me emërimin e Bordit për Trajnime Bilaterale i nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes, ka konstatuar se përzgjedhja e kandidatëve për trajnime jashtë vendit nga kjo ministri është bërë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, ku ndër të tjera theksohen edhe kriteret si në vijim, citoj: 2.1.Përshatshmëria e kursit/ shkollimit në relacion me specialitetin apo fushën e kandidatit, 2.2.Performanca e kandidatit, 2.3.Koha e qëndrimit në gradë, 2.4.Kushtet e ofertës së kursit/aktivitetit stërvitor, 2.5.Koha maksimale prej gjashtë muajve pas kthimit nga kursi/aktiviteti stërvitor dhe 2.6. Kandidati i cili është në tri vitet e fundit para pensionimit nuk do të merret në konsideratë për trajnimet që zgjasin më shumë se tre muaj. Ndërlidhur me këtë, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka aplikuar për trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security Context Course", i organizuar nga Mbretëria e Bashkuar për periudhën 23 maj-08 korrik 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se me datën 28.01.2022 kapitene Manushaqe Nura pranë Ministrisë së Mbrojtjes, pas pranimit të ftesës lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security" e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, për periudhën prej 23 maj-08 korrik 2022, përmes e-mailit zyrtar, ka dërguar ftesën tek Shefi i Sektorit për Arsimim dhe Trajnim-Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes. Ky i fundit me datën 28.01.2022, përmes e-mailit zyrtar i ka njoftuar Drejtorët e Departamenteve dhe Shefat e njësive në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, lidhur me propozimet e tyre për kandidatët pjesëmarrës. Si kandidatët pjesëmarrës në këtë trajnim, të propozuar nga ana e Udhëheqësve të tyre kanë qenë këta kandidat: dhe

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ligjshmërinë e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për këtë trajnim, ka konstatuar se është bazuar në Vendimin me numër Nr.prot.383 të datës 24.02.2022 lidhur me emërimin e Bordit për Trajnime Bilaterale i nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes, ku janë precizuar edhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara për përzgjedhjen e kandidatëve pjesëmarrës. Bazuar në shkresat e lëndës Bordi për Trajnime Bilaterale i përberë nga shtatë (7) anëtar, me datën 01.03.2022 pas takimit të mbajtur lidhur me shqyrtimin e propozimeve për kandidatët pjesëmarrës, të dërguar nga ana e Udhëheqësve të tyre, mori vendim që për trajnimin

“Menaging Defence in the Wider Security” e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, për periudhën prej 23 maj-08 korrik 2022, nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës të dërgohen për intervistim këta kandidat: nga Ministria e Mbrojtjes, nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Kandidatët e propozuar dhe me datën 02.03.2022 janë njoftuar se do ti nënshtrohen intervistës me datën 03.03.2022, nga shteti partner konkretisht nga OF4 Hunter të mbështetur nga OF5 Ndërsa me datën 03.03.2022, nga kapitenja përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar Shetin e Sektorit për Arsimit dhe Trajnim-Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me performancën e pjesëtarëve për MDËSC sipas vlerësimit të shtetit partner, ku në këtë vlerësim është renditur i pari nga Ministria e Mbrojtjes si fitues për pjesëmarrjen dhe kryerjen e kursit-trajnimit për “Menaging Defence in the Wider Security” e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, për periudhën prej 23 maj-08 korrik 2022.

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit, lidhur me mos përzgjedhjen e tij në këtë trajnim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar pozitën e punës së ankuesit e që sipas akt emërimit të datës 15.07.2011 del se i njëjti mban pozitën si “Shef i njësisë së protokollit”, në Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërlidhur me këtë ka konstatuar se trajnimi për “Menaging Defence in the Wider Security” i organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, që nënkupton menaxhimin e mbrojtjes në kontekstin e gjerë të sigurisë, nuk i përket fushës në të cilën ankuesi e mban pozitën si dhe nuk përkon me pikën 2,2.1 të Vendimit me numër Nr.prot.383 të datës 25.02.2022, fillimisht si pikë e parë e përzgjedhjes së kandidatëve, lidhur me përshtatshmërinë e kursit/shkollimit në relacion me specialitetin apo fushën e kandidatit, andaj në këtë kontekst Kolegji ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i pa bazuar nga se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret të parapara si në vendimin e specifikuar më lartë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues, pasi ka analizuar dëshmitë dhe provat e siguruara nga organi i punësimit lidhur me dosjen e kandidatit fitues për trajnimin “Menaging Defence in the Wider Security” e organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, për periudhën prej 23 maj-08 korrik 2022, ka konstatuar se kandidati i zgjedhur sipas këtij trajnimi Agron Durmishi mban pozitën “Shef i sektorit për politika dhe strategji” sipas akt emërimit të datës 13.03.2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, e që pozita të cilën e mban me akt emërim është pozitë e cila i përshtatet fillimisht fushës së trajnimit/shkollimit të kandidatit, si parakusht themelor për pjesëmarrjen në këtë trajnim. Sipas dëshmimeve në shkresat e lëndës, del se i njëjti sipas akt emërimit në kategorinë funksionale mban gradën A4, po ashtu si kusht për kohën e qëndrimit në gradë. I njëjti ka të përfunduara trajnimet lidhur me: “Projekti DECOS, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut” nga Qendra Europiane për Studime të Sigurisë për periudhën prill-shtator 2021 online si dhe kursin bazik për marrëdhënie me publikun PARC-Shkup, për periudhën prej 20 deri me 25.04.2015 si kusht lidhur me kohën maksimale prej gjashtë muajve pas kthimit nga kursi/aktiviteti stërvitor paraprak, të gjitha këto si kriteret themelore të përcaktuara sipas Vendimit me numër Nr.prot.383 të datës 24.02.2022, mbi përzgjedhjen e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit të atakuar në ankesë lidhur me atë se i njëjti nuk ka mundur ta atakoj me ankesë vendimin mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues për këtë trajnim i cili është publikuar me datën 04.03.2022 ne web

faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka konstatuar se me datën 18.03.2022, Shefi i sektorit për hartimin e legjislacionit në Departamentin ligjor ka dhënë opinionin ligjor bazuar në kërkesën e ankuesit të datës 11.03.2022 përmes e-mailit zyrtar, ku ka sqaruar edhe procedurën ligjore të ankuesit lidhur me parashtrimin e ankesës se tij sipas legjislacionit në fuqi, andaj në këtë kontekst pretendimi i ankuesit është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, lidhur me mos dhënien e mundësisë për parashtrimin e ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.5/2/08/2022 i datës 04.03.2022, i nxjerrë nga Bordi Përzgjedhës i Ministrisë së Mbrojtjes lidhur me përzgjedhjen e kandidatit fitues për trajnimin "Menaging Defence in the Wider Security", i organizuar nga Mbretëria e Bashkuar, për periudhën prej 23 maj-08 korrik 2022, është nxjerrë duke u bazuar në Vendimin Nr.prot.383 të datës 24.02.2022, nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes sipas kriterëve të përcaktuara për plotësimin e kushteve të parapara lidhur me pjesëmarrjen në këtë trajnim dhe i njëjti është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.252/2022, datë 17.05.2022

Ardita Përçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

